



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 88/13 Prot.

Tiranë, më 13.09.2016

V E N D I M

Nr.101, datë 13/09/2016

"Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit"

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nenet 14, germa "b", 32 dhe 33, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 (më poshtë "Rregullores"), si dhe neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", lejuar të përdoren sipas nenit 185, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", shqyrtimit të materialit, observacioneve të institucionit të mbikëqyrur dhe mendimit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme, zhvilluar në institucionin e Agjencia Kombëtare e Bregdetit,

VËREJ SE:

Në zbatim të Vendimit nr. 16 datë 03.02.2016, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit", filloi mbikëqyrja e përgjithshme në subjektin, Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion ishte i përgjithshëm, duke përfshirë të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat, evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; respektimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës; miratimin e planit vjetor të pranimin në shërbimin civil; plotësimi i pozicioneve të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil; transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; pezullimin nga shërbimi civil; realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civilë; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civilë në periudhë prove, e aspekte të tjera të administrimit të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes, grupi i punës ka hartuar projekt raportin dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur, me shkresën nr. 88/5 prot., datë 05.05.2016, “*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes*”, duke i lënë kohën e mjaftueshme për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin.

Po kështu projektraporti i mbikëqyrjes iu njoftua edhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në cilësinë e institucionit që e ka në varësi institucionin e mbikëqyrur, me shkresën nr. 88/9 prot., datë 25.05.2016, “*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes*”, si dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse me shkresën nr. 88/6 prot., datë 05.05.2016 “*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes*”.

Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, si dhe nga Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 2161/1 prot., datë 24.05.2016, “*Përcillet observacioni mbi projekt raportin e mbikëqyrjes së përgjithshme pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit*”.

Nga përmbajtja e materialeve dokumentare, rezulton se subjekti i mbikëqyrur është shprehur përgjithësisht dakord me konkluzionet e arritura nga grupi i punës, por kërkon marrjen në konsideratë të disa pretendimeve të pasqyruara në observacionin e paraqitur pranë Komisionerit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me kërkesat e parashtruara në observacionin e paraqitur nga institucioni i mbikëqyrur, ka dhënë përgjigjen ligjore të materializuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe nenet 32, 33 dhe 35, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17 datë 11.03.2015 të Komisionerit,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. Njësia përgjegjëse (DAP), të revokojë aktet e deklaramit të statusit të punësimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me ligjin, si dhe të ndërpresë marrëdhënien e punës, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit për nëpunësin civil, si dhe të akteve nënligjore që rregullojnë këtë proces (VKM nr. 116, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë...”, i ndryshuar), për rastet si më poshtë:

- Të revokohet akti nr. 3302/4, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësën ***** si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Zhvillimit Detar dhe Bregdetar” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të revokohet akti nr. 3302/10, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësën ***** si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist Arkiv Protokoll, Burime Njerëzore” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të revokohet akti nr. 3302/8, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësën ***** si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist, Dega Rajonale Durrës” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të revokohet akti nr. 3302/3, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësën ***** si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist, Dega Rajonale Durrës” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të revokohet akti nr. 3302/5, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësën ***** si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Planifikimit Territorial dhe Menaxhimit të Zonave Bregdetare”, si dhe aktin nr. 4253/1, datë 25.09.2015, i Departamentit të Administratës Publike, që transferon këtë punonjëse në pozicionin “Titullar, në Dega Rajonale Sarandë” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore.

Njësia përgjegjëse, të kujdeset që këto pozicione, t’i shpallë vende vakante dhe t’i plotësojë nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur, apo lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, sipas rastit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, dalë në bazë e për zbatim të tij.

3. Për rregullimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në rastin e punonjësës ***** , të veprohet si më poshtë :

- Të revokohet akti nr. 92/2, datë 08.02.2016, të titullarit të institucionit, “Për lirim nga shërbimi civil”, për punonjësën ***** , si akt absolutisht të pavlefshëm.

- Njësia e burimeve njerëzore, të drejtoje procesin, duke u kujdesur që, personat e ngarkuar me ligj për kryerjen e procesit të vlerësimit të rezultateve individuale në punë, në periudhë prove, për nëpunësen *****, të revokojnë “*Formularin e vlerësimit*”, të periudhës së provës, Janar 2015 - Janar 2016.
 - Të bëhet rivlerësimi i kësaj nëpunëseje për periudhën e provës, në mënyrë objektive dhe të plotë, duke respektuar përcaktimet ligjore të nenit 62, të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, si më poshtë:
 - o Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë duhet të respektojë të gjitha fazat përkatëse të vlerësimit si planifikimin, bisedimet e ndërmjetme dhe vlerësimin përfundimtar, duke u shoqëruar me dokumentacionin përkatës që materializon zhvillimin e këtyre fazave.
 - o Njëkohësisht formulari i vlerësimit duhet të përmbajë komentet përkatëse në të gjitha rubrikat e saj, për të identifikuar aftësitë dhe dobësitë e nëpunësit civil, për të cilin bëhet vlerësimi, në mënyrë që të sugjerohen trajnime dhe mundësi të tjera, për zhvillimin profesional të nëpunëses *****.
 - Të revokohet akti i titullarit të institucionit të mbikëqyrur, nr. 6, datë 03.02.2016, “*Për moskonfirmimin e statusit të nëpunësit civil të ******”, si akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.
4. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, të plotësojë dosjet e personelit të çdo nëpunësi civil, sipas detyrave konkrete që janë lënë në Kapitullin nr. 9, të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, që do të jetë pjesë e këtij vendimi, si dhe të administrojë në dosjen e personelit dokumentet që mungojnë, të evidentuara në aneksin përkatës, që është pjesë e raportit.
 5. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse (DAP), të marrin masat, sipas orientimeve që janë dhënë në kapitullin ku janë trajtuar dosjet e personelit, për të plotësuar dosjen e punonjësit *****, duke pasur parasysh edhe detyrimin që ka punonjësi në këtë rast, sipas lidhjes nr. 1, pika 3, germa “b”, të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, për të dorëzuar të gjitha të dhënat që provojnë edukimin e tij arsimor, të tilla si “*Diploma e shkollës së lartë, lista e notave*”, ose një dokument të barasvlershëm me diplomën, në formën e vërtetimit të lëshuar nga institucioni përkatës për arsimin e lartë, sipas përcaktimeve të nenit 91, pika 4, të ligjit nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”.
 6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Subjekti i mbikëqyrur, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe njësia përgjegjëse (DAP) duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

7. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe njësi përgjegjëse (*DAP*), duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
8. Për këtë vendim të njoftohet Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në cilësinë e institucionit që e ka në varësi, Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke u dërguar nga një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA